



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr.12, datë 10.07.2024

“Ftesë publike për bashkëpunim drejtuar organeve të medias audiovizive, medias së shkruar, medias online dhe asaj elektronike, për të shprehur interesin për të kontribuar me ekspertizën e tyre në veprimtaritë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar dhe Grupeve të Ekspertëve”

Bazuar në nenet 24 dhe vijues, të Rregullores së Kuvendit dhe në pikën VIII, të vendimit nr. 50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, me propozim të kryetarit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

VENDOSI:

1. T’u drejtohet me një “Ftesë publike për bashkëpunim”, organeve të medias audiovizive, medias së shkruar, medias online dhe asaj elektronike, të cilat kanë në fokus të angazhimit të tyre trajtimin e çështjeve që lidhen me 3 fushat kryesore objekt pune të këtij komisioni, i) Mirëqeverisja; ii) Antikorrupsioni dhe iii) Sundimi i Ligjit, për të shprehur interesin për përfshirje aktive në aktivitetet e organizuara nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar si dhe për të ofruar kontributet e tyre në këtë proces pranë Grupit të Ekspertëve.
2. Të autorizojë kryesinë e Komisionit për të publikuar ftesën nëpërmjet kanaleve të informimit në dispozicion dhe për t’u komunikuar organeve të interesuara të medias vendimin e Kuvendit, qëllimin, objektin e punës së komisionit, organizimin, kohën e veprimtarisë së tij dhe metodologjinë e angazhimit të tyre në këtë proces.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Fatmir XHAFAJ

Miratuar më 10.07.2024